

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7062
E hënë, 4 dhjetor 2023
Çmimi 0.50

Zgjedhjet e parakohshme në veri s'pritet të mbahen gjatë këtij viti | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NJË MUAJ PARABURGIM NDAJ TË DYSHUARVE PËR VRASJEN E LIRIDONËS. | FAQE 5

Granit Plava **Naim Murseli** **Kushtrim Kokalla**

Liridona

Tre të dyshuarit për organizimin dhe vrasjen e Liridona Murselit janë paraqitur të dielën para Gjykatës Themelore të Prishtinës. Gjykata ua ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji bashkëshortit të Liridonës, Naim Murselit, i dyshuar për organizim të vrasjes, G. P., i dyshuar se kreu vrasjen dhe K. K., pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës, për shkak të veprës penale "marrëveshje për ta kryer veprën penale vrasje e rëndë". Para gjykatës është organizuar një aksion kundër dhunës ndaj grave, ndërkohë që për të martën, më 5 dhjetor, është thirrur protestë në Prishtinë.

AKTUALE



IZRAELI ZGJERON URDRAT PËR EVAKUIM DERISA PO ZHVENDOS OFENSIVËN NË GAZËN JUGORE | F. 2

KURTI MBAN TAKIM ME QENDRAT E LV-SË, KËRKON ZGJERIM TË ANËTARËSISË | F. 6

SHËNOHET DITA NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, BËHET THIRRJE PËR PËRKRAHJE MERITORE | F. 6

EKONOMI



KOSOVA, VEND TRANSIT PËR PUNËTORËT AZIATIKË | F. 7

DOGANA KALON 1.5 MILIARD EURO TË HYRA | F. 7

SPORT



FITOJNË BALLKANI DHE DRITA, DUKAGJINI NDAHET BARAS ME PRISHTINËN | F. 10

KRASNIQI: QEVERIA KURTI I MBUSHI INSTITUCIONET ME FAMILJARË DHE MILITANTË PARTIAKË | F. 6



MBROJTJA E KADRI VESELIT I REAGON PROKURORISË PËR PËRGJIMET NË BURG | F. 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli zgjeron urdhrat për evakuim derisa zhvendos ofensivën në Gazën jugore

Jerusalem, 3 dhjetor - Ushtria izraelite të dielën urdhëroi evakuimin e më shumë zonave në dhe rreth qytetit të dytë më të madh të Gazës, Khan Younis, pasi e zhvendosi ofensivën në gjysmën jugore të territorit ku, sipas ushtrisë, janë fshehur shumë udhëheqës të Hamasit.

Bombardime të rënda u raportuan gjatë natës dhe të dielën në qytetin Khan Younis dhe në qytetin jugor Rafah, si dhe në pjesën veriore që ishte në qendër të fushatës së ashpër ajrore dhe tokësore të Izraelit.

Shumë nga 2.3 milionë banorët e territorit janë grumbulluar në jug, pasi forcat izraelite urdhëruan civilët të largoheshin nga veriu në ditët e para të luftës.

Me rifillimin e luftimeve, pothuajse u shuan shpresat se mund të negociohej një tjetër armëpushim i përkohshëm. Një armëpushim njëjavor, i cili skadoi të premten, mundësoi lirinë e dhjetëra pengjeve izraelite dhe të huaj të mbajtur në Gaza dhe palestinezëve të burgosur nga Izraeli. "Ne do ta vazhdojmë luftën derisa t'i arrijmë të gjitha qëllimet dhe është e pamundur të përmbushen ato synime pa operacionin tokësor", tha në një fjalim të shtunën në mbledhje kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu.

Të dielën ushtria izraelite zgjeroi urdhrat e evakuimit në dhe rreth qytetit Khan Younis, duke u kërkuar banorëve të të paktën pesë zonave dhe lagjeve të tjera, që të largoheshin për hir të sigurisë së tyre.

Banorët thanë se ushtria izraelite hodhi afishe duke i urdhëruar ata të lëviznin në jug në Rafah ose në një zonë bregdetare në jugperëndim. "Qyteti Khan Younis është një zonë e rrezikshme luftarë", thuhej në afishe. Vëzhguesit e Kombeve të Bashkuara thanë në një raport të publikuar përpara urdhrave të fundit të evakuimit se ata që u ishte thënë të largoheshin përbënin rreth



një të katërtën e territorit të Gazës, shtëpia e gati 800 000 njerëzve para luftës.

Shtetet e Bashkuara, aleati më i afërt i Izraelit, e ka paralajmëruar Izraelin që t'i shmangë zhvendosjet e reja masive.

Ushtria izraelite tha të dielën se avionët dhe helikopterët e saj "goditën objektivat terroriste në Rripin e Gazës, duke përfshirë tunelet, qendrat e komandës dhe depot e armëve" gjatë natës, ndërsa një dron vrau pesë luftëtarë të Hamasit.

Në Gazën veriore, ekipet e shpëtimit me pak pajisje po përpiqeshin të dielën të gërmojnë nëpër rrënojat e ndërtesave në kampin e refugjatëve Jabaliya dhe lagje të tjera në qytetin e Gazës, në kërkim të të mbijetuarve të mundshëm dhe trupave të të vrarëve.

Ministria e Shëndetësisë në Gazën drejtuar nga Hamasi tha të shtunën se numri i përgjithshëm i vdekjeve që nga fillimi i luftës më 7 tetor është

mbi 15 200. Ministria nuk bën dallimin midis civilëve dhe luftëtarëve, por tha se 70 për qind e të vrarëve janë gra dhe fëmijë. Ajo tha se më shumë se 40 000 njerëz janë plagosur që nga fillimi i luftës.

Thirrjet e Shteteve të Bashkuara për mbrojtjen e civilëve u shtuan pasi një ofensivë në javët e para të luftës shkatërroi zona të mëdha të Gazës veriore. Pjesa më e madhe e popullsisë së Gazës është e grumbulluar në gjysmën jugore të territorit. Vetë Rripi i Gazës në kufi me Izraelin dhe Egjiptin në jug është i mbyllur, duke u lënë banorëve mundësinë e vetme për të lëvizur brenda Gazës për t'i shmangur bombardimet. "Shumë palestinezë të pafajshëm janë vrarë. Sinqerisht, shkalla e vuajtjes së civilëve dhe imazhet dhe videot që vijnë nga Gaza janë shkatërruese", u tha gazetarëve të shtunën nënpresidentja amerikane Kamala Harris në Dubai.

Mark Regev, një këshilltar i lartë i kryeministrit Netanyahu, tha se

Izraeli po bën "përpjekje maksimale" për t'i mbrojtur civilët dhe ushtria ka përdorur afishe, thirrjet telefonike dhe transmetimet në radio dhe televizion për t'i nxitur banorët e Gazës të lëvizin nga zona të veçanta. Ai shtoi se Izraeli po shqyrton krijimin e një zone të veçantë sigurie.

Izraeli thotë se synon operativët e Hamasit dhe fajëson militantët për viktimat civile, duke i akuzuar ata se veprojnë në lagje të banuara. Ai pretendon se ka vrarë mijëra militantë, pa dhënë prova. Izraeli thotë se të paktën 78 ushtarë të tij janë vrarë gjatë ofensivës në veri të Gazës.

Bombardimet të shtunën shkatërruan një bllok prej rreth 50 ndërtesash banimi në lagjen Shijaiyah të qytetit të Gazës dhe një ndërtesë gjashtëkatëshe në kampin urban të refugjatëve Jabaliya në skajin verior të qytetit, tha zyra e OKB-së për Bashkërendimin e Çështjeve Humanitare.

Më shumë se 60 njerëz u vranë në

sulmet në Shijaiyah dhe më shumë se 300 mbetën nën rrënoja, thanë vëzhguesit, duke cituar Gjysmëhënën e Kuqe Palestineze.

Në bisedimet me presidentin egjiptian Abdel Fattah el-Sisi, nënpresidentja Harris tha se "në asnjë rrethanë Shtetet e Bashkuara nuk do ta lejojnë zhvendosjen e detyruar të palestinezëve nga rripi i Gazës ose Bregu Perëndimor, rrethimin e Gazës ose ndryshimin e kufijve të rajonit", thuhej në një deklaratë të Shtëpisë së Bardhë.

Lufta filloi pasi një sulm i 7 tetorit nga Hamasi dhe militantët e tjerë la pas vetes rreth 1 200 të vrarë, kryesisht civilë, në jug të Izraelit. Rreth 240 persona u morën peng. Armiqësitë e ripërtëritë kanë shtuar shqetësimet për 137 pengje të cilët ushtria izraelite thotë se janë ende në duart e militantëve, pas 105 të liruave gjatë armëpushimit të fundit. Izraeli liroi 240 palestinezë gjatë armëpushimit. Shumica e të liruave nga të dyja palët ishin gra dhe fëmijë.

Harris skicon vizionin e ShBA-së për Gazën pas konfliktit



WASHINGTON, 3 DHJETOR - Nënpresidentja amerikane Kamala Harris i ka paraqitur objektivat amerikane pasi të përfundojë konflikti Izrael - Hamas, duke theksuar se populli palestinez në Gazë dhe në Bregun Perëndimor, duhet të ribashkohet nën një entitet qeverisës.

Hamasi është grup palestinez i shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian.

Harris i ka bërë këto deklarata në një samit për klimën që po

mbahet në Dubai, me kërkesë të presidentit amerikan Joe Biden, teksa ai mbetet i fokusuar në luftën Izrael - Hamas.

Në bisedimet me presidentin e Egjiptit, Abdel Fattah Al-Sisi of Egjipt, Harris ka thënë se "nën asnjë rrethanë Shtetet e Bashkuara nuk do të lejojnë rilokim të sforcuar të palestinezëve nga Gaza apo Bregu Perëndimor, apo rishkrim të kufijve të Gazës", ka thënë Shtëpia e Bardhë përmes një deklaratë.

Ajo ka thënë, po ashtu, se pasi të përfundojë lufta, përpjekjet për

rindërtim duhet të jenë në kontekst të "një vizioni të qartë politik për popullin palestinez drejt një shteti të udhëhequr prej një Autoriteti të ringjallur Palestinez, që do ta ketë mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar dhe shteteve në rajon", është thënë në deklaratë. "Nënpresidentja e ka bërë të qartë se Hamasi nuk mund ta kontrollojë Gazën e cila është e paqëndrueshme për sigurinë e Izraelit, për sigurinë e popullit palestinez dhe sigurinë rajonale", ka thënë Shtëpia e Bardhë.

Osmani dhe Rutori konfirmuan përkushtimin për të punuar për thellimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Kenias

Prishtinë, 3 dhjetor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila po qëndron në Dubai, ku po mbahet COP28, konferenca kryesore globale për ndryshime klimatike, ka zhvilluar një takim me presidentin e Republikës së Kenias, William Ruto. Në takim është diskutuar për raportet dypalëshe Kosovë - Kenia si dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Presidentja Osmani ka theksuar se thellimi i raporteve në mes të dy shteteve është në të mirë të qytetarëve tanë dhe do ta nxisë shkëmbimin ekonomik e tregtar në mes të vendeve tona. Ajo e njoftoi presidentin e Kenias për

sfidat në të cilat ka kaluar Kosova si dhe për të arriturat e shtetit tonë. Presidentja Osmani dhe presidenti Rutor konfirmuan përkushtimin e përbashkët për të punuar për thellimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Kenias. Osmani është takuar edhe me presidentin e Emirateve, Sheikh Mohamed bin Zayed Al Nahyan, me të cilin kanë diskutuar për një epokë të re në partneritetin tonë. Ajo ka thënë se mbështetja e Emirateve të Bashkuara Arabe në kohën më të vështirë për popullin tonë është dëshmi e lidhjes së fortë në mes të dy shteteve tona.

“Në takim diskutuam hollësisht potencialin e zgjerimit dhe thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, rritjes së investimeve në sektorë strategjikë dhe për forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës. E përgëzoja për organizimin e suksesshme të COP28 - konferencës kryesore globale për ndryshimet klimatike, në të cilën konferencë Kosova po merr pjesë për herë të parë në nivelin më të lartë shtetëror, me ftesë të Lartmadhërisë së Tij. Mirënjohës pafundësisht për mikpritjen e jashtëzakonshme!”, ka thënë Osmani.



Qeveria shtyn për vitin 2024 miratimin e Kodit Civil

Prishtinë, 3 dhjetor - Në mbledhjen e saj të 172-të, Qeveria e Kosovës ka ndryshuar programin legjislativ për vitin 2023. Ajo ka bartur për vitin tjetër 21 projektligje të planifikuara për këtë vit, ka tërhequr një projektligj për këtë vit si dhe ua ka ndryshuar afatin e miratimit 20 projektligjeve, përderisa ka shtuar edhe dy projektligje për miratim.

Në mesin e projektligjeve të bartura është edhe ai i Kodit Civil të Kosovës. Në fjalën e tij, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk përmendi ndonjë arsye të qartë se cilat janë shkaqet e shtyrjes së miratimit të Kodit Civil. Ai tha se për shkak të planifikimit më të mirë duhet shqyrtuar dhe miratuar vitin e ardhshëm 21 projektligjet e shtyra, raporton “Betimi për Drejtësi”. “Ky vit ashtu si dhe ai paraprak ka shënuar miratimin e një numri rekord projektligjesh



pasi që pothuajse çdo fushë e menaxhuar nga autoriteti qendror ishte në nevojë të inicimit të reformës që do të siguronte zhvillim dhe mbarësi si për qytetarin e republikës ashtu edhe për institucionet shtetërore”, tha Kurti. Për herë të parë Kodi Civil ishte proceduar për miratim në vitin 2022, por që ai nuk ishte miratuar nga ana e Kuvendit të Kosovës më

16 mars 2022. Përkundër sigurimit të kuorumit për këtë projektligj, ai kishte marrë vetëm 28 vota për, ndërsa 29 kundër dhe 4 abstenime. Në seancë ishin të pranishëm edhe 16 deputetë të pranishëm, por ata nuk morën pjesë fare në votim. Në procesin e votimit nuk kishin marrë pjesë deputetët e opozitës. Projektligji ishte kundërshtuar kryesisht nga disa deputetë të

grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Disa prej tyre kishin përmendur edhe gjuhë jo të përshtatshme, të cilën e kishte kritikuar në po të njëjtën seancë edhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca.

Pasi që nuk kishte kaluar projektligji, shtatë muaj më pas ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, kishte thënë se shumë shpejt do të riprocedohet për votim në Kuvend, Projektkodi Civil. Sipas saj, kësaj radhe ky kod do të kalojë. “Projektkodin Civil shumë shpejt do ta procedojmë në Kuvend, dhe kësaj radhe do të kalojë në Kuvend, sepse është një dokument i rëndësishëm”, kishte thënë Haxhiu.

Edhe shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, duke folur për sesionin pranveror të Kuvendit për vitin 2022, kishte thënë se Kodi Civil do të trajtohet në sesionin vjeshtor (2022) të

Kuvendit të Kosovës. Përkundër shpejtësisë së premtuar, Projektkodi Civil ishte planifikuar të miratohej në qeveri më 30 qershor 2023, por nuk ishte miratuar sipas planifikimeve. Në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, qeveria ndryshoi programin legjislativ për këtë vit me ç’rast hoqi nga planifikimi i miratimit këtë projektkod. Projektkodin Civil e kishte përkrahur ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier, sipas të cilit, ky kod është i nevojshëm sepse Kosova ka nevojë për kod të shekullit XXI.

Në lidhje me hezitimin e deputetëve për ta miratuar këtë kod, në një intervistë për emisionin “Tempus”, Lisa A. Johnson, zëvendësdihmësekretare e Shtetit për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit, kishte thënë se Kushtetuta e Kosovës anon për çështjen e martesave të së njëjtës gjini.

Mbrojtja e Kadri Veselit i reagon Prokurorisë për përgjimet në burg

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Mbrojtja e Kadri Veselit ka kundërshtuar ashpër pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar rreth bisedave të përgjuara në Qendrën e Paraburgimit në Hagë, duke thënë se bisedat janë paraqitur në mënyrë të shtrembëruar nga ana e prokurorisë, e që bazohen në supozime, thashetheme dhe deklarata mashtruese.

Mbrojtja e Veselit konstaton se klienti i tyre në asnjë moment nuk ka cenuar identitetin e dëshmitarëve apo dëshmitë e tyre dhe në asnjë mënyrë nuk ka penguar procedurat pranë Dhomave të Specializuara. Siç transmeton RTV Dukagjini, në shkresën e avokatit Ben Emmerson thuhet se Veseli ka bërë të

kundërtën e asaj që pretendon prokuroria. “Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk ka paraqitur asnjë provë se Veseli ka bërë përpjekje për të ndërhyrë në drejtësi apo penguar procedurat”, thuhet në shkresën e avokatit Emmerson. Sipas avokatit britanik, nga volumi i madh i provave që ka dhënë prokuroria, Veseli vetëm sa thekson rëndësinë e parimit themelor që askush nuk duhet t’i qaset asnjë dëshmitari, pasi kjo do ta dëmtonte atë, në vend që ta ndihmonte. “ZPS-ja ka paraqitur një pamje të shtrembëruar, pa identifikuar qartë se çfarë pretendon, se z. Veseli ka bërë gabim. Në fakt, shqyrtimi i plotë i materialit të shpalosur dëshmon përfundimin e kundërt nga rasti i paraqitur nga SPO




kundër z. Veseli”. Emmersoni përgjimin në dhomat e Qendrës së Paraburgimit në Hagë e ka quajtur si mënyrë klandestine nga SPO. Mbrojtja e Veselit ka dëshmuar konkretisht

se si në tri raste nuk qëndrojnë aspak pretendimet e prokurorisë. “Sa i përket dërgimit të mesazheve nga qendra e paraburgimit, Veseli thjesht thotë që secili ka grupin e vet të

avokatëve dhe ju betohem, nuk ka arsye për të dërguar mesazh nga ky vend... Jo, sepse jam duke folur, por nuk ka asgjë për të ... çfarë do të thuash?”

Ai paralajmëroi në mënyrë specifike një nga vizitorët e tij: “Mbani distancë! Edhe nëse keni dëgjuar ndonjëherë për dikë që do të vijë të dëshmojë këtu; edhe nëse dikush vjen dhe të thotë ‘Unë jam [dëshmitar]’, mund t’i thuash thjesht ‘thuaj të vërtetën’, ‘vetëm mos gënje’, thjesht mos gënje. Nuk ka nevojë të flasësh; ne nuk kemi nevojë për asgjë, vetëm të mos gënjejë. Nëse nuk gënjejnë, do të jemi mirë, sepse realiteti i UÇK-së është i tillë. Kjo është. Nuk ka nevojë të bëhet asgjë”, ka shkruar mbrojtja.



Një muaj paraburgim ndaj të dyshuarve për vrasjen e Liridonës

Tre të dyshuarit për organizimin dhe vrasjen e Liridona Murselit janë paraqitur të dielën para Gjykatës Themelore të Prishtinës. Gjykata ua ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji bashkëshortit të Liridonës, Naim Murselit, i dyshuar për organizim të vrasjes, G. P., i dyshuar se kreu vrasjen dhe K. K., pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës, për shkak të veprës penale “marrëveshje për ta kryer veprën penale vrasje e rëndë”. Para gjykatës është organizuar një aksion kundër dhunës ndaj grave, ndërkohë që për të martën, më 5 dhjetor, është thirrur protestë në Prishtinë

M. e kishte pajisur me armë të pandehurin G. P. dhe kishin inskenuar veprën penale të grabitjes, e cila është realizuar me datë 29.11.2023 rreth orës 20:25 minuta në fshatin Bernicë, komuna e Prishtinës, në atë mënyrë që derisa i pandehuri N. M. ishte duke lëvizur me veturën e tij, në të cilën kanë qenë e ndjera L.

M. dhe dy fëmijët e tyre, papritmas ka dalë para veturës i pandehuri G. P. me maskë në kokë dhe revole në dorë, ku sipas marrëveshjes paraprake i pandehuri N. M. me fëmijët kishin dalë nga vetura dhe ishte larguar nga vendi i ngjarjes kinse për të ikur, ndërsa në veturë kishte mbetur tani e ndjera, të cilën i pandehuri G. P. e kishte qëlluar

nga afërsia me një plumb në qafë dhe, si pasojë e plagës vdekjeprurëse, e ndjera L. M. kishte ndërruar jetë në vendin e ngjarjes, ndërsa për këto veprime i pandehuri N. M. paraprakisht i kishte premtuar të pandehurit G. P. shumën e të hollave prej 30 000.00 eurosh”, është thënë në komunikatë.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masë paraburgimi prej një muaji ndaj tre të dyshuarve me inicialet N. M., G. P. dhe K. K. për vrasjen e Liridona Murselit. N. M., për shkak të veprës penale “vrasje e rëndë në bashkëkryerje”, G. P. për veprën penale “vrasje e rëndë dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe K. K. për shkak të veprës penale “marrëveshja për ta kryer veprën penale vrasje e rëndë”.

Liridona është vrarë më 29 nëntor në Prishtinë. Në mesin e të dyshuarve për vrasjen e 30-vjeçares është edhe burri i saj Naim Murseli. Gjykata e ka marrë vendimin pas një seance dëgjimore që e ka mbajtur të dielën për këtë rast.

Në vendim është thënë se ekziston dyshimi i bazuar për përsëritje të veprës penale. “Ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri N. M. me dashje që ta privojë nga jeta në mënyrë dinake bashkëshorten e tij, ishte marrë vesh me të pandehurin G. P. për ta vrarë tani të ndjerën L. M., ku paraprakisht i pandehuri N.



Seanca ka nisur në orën 9:30 të dielën dhe ka qenë e mbyllur për mediet.

Avokatët mbrojtës nuk janë deklaruar pas seancës.

Afër gjykatës janë parë familjarë të Liridonës, por ata nuk janë lejuar të marrin pjesë në seancën e parë.


Vëllai i Liridonës, Leonard Ademaj, ka thënë se është njoftuar që duhet të bëjë kërkesë për të marrë pjesë në seancat e radhës. Ai ka thënë se i ka dorëzuar kërkesë Prokurorisë për zhvarrosjen e trupit të Liridonës dhe rivarrosjen e saj afër varrezave të shtëpisë së prindërve të saj. "Liridona është vvarë në mënyrën më mizore, në mënyrën më makabre që mund të jetë. Liridona ishte grua e fuqishme, motër e fuqishme dhe nënë e fuqishme. Doli të bëhet edhe heroinë për fëmijët e vet. Ne po e përmbajmë veten, sepse ajo nuk donte të na shihte neve kurrë kështu", ka thënë vëllai i saj pas seancës.

Ai ka thënë se beson që autoritetet e Kosovës do të vendosin drejtësi në këtë rast.

Në hyrje të ndërtesës është mbajtur një protestë nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist, me mbishkrimin "Nuk ka paqe pa sigurinë e grave". "Vendi ynë nuk mund të ketë paqe përderisa gratë çdo ditë përjetojnë gjendje lufte. Luftë për ekzistencë, luftë për të mos u dhunuar, luftë për të mos u vvarë", ka thënë Trina Binaku nga organizata.

Vrasja e Liridonës ka marrë vëmendje të madhe, pasi fillimisht ajo ishte raportuar nga Policia e Kosovës si "grabitje me pasoja të vrasjes".

Pas arrestimit, "Betimi për Drejtësi", medium i specializuar në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë, ka raportuar, bazuar në burime, se i dyshuari Naim Murseli e ka pranuar para hetuesve se e ka porositur vrasjen për bashkëshorten e tij.



"Burime të 'Betimit për Drejtësi' bëjnë me dije se i dyshuari Murseli ia kishte dhënë të dyshuarit G. P. 15 mijë euro para vrasjes, 15 mijë të tjera do t'ia jepte pas kryerjes së veprës", është thënë në raportimin

Haradinaj shkon për ngushëllime te familja e Liridonës

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, së bashku me kryetarin e Gjakovës, Ardian Gjini dhe bashkëpunëtorë, ka qëndruar në familjen e Hajdar Ademajt në fshatin Rracaj për t'i shprehur ngushëllime për vajzën, Liridonën, edhe pse, sipas tij, në një rast si ky fjalët nuk

kanë peshë. "Lehtësimi për familjen e për shoqërinë vjen vetëm nga puna e mirë e organeve të rendit dhe drejtësisë. Forcimi i mëtejme i shtetit ligjor është parakusht që të mos ketë vend më për krime si ky kurrë më në shoqërinë tonë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Familja e Liridona Ademajt falënderon të gjithë për ngushëllimet: Kriminelët duhet të kalben në burg

Vëllai i të ndjerës Liridona Ademaj, Leonard Ademaj, në "Facebook" i ka falënderuar të gjithë qytetarët për ngushëllimet dhe mbështetjen publike, teksa ka bërë thirrje për drejtësi në rastin e vrasjes së rëndë e të porositur të motrës së tij nga bashkëshorti i saj. "Përshëndetje! Unë jam Leonard Ademaj, jam vëllai i Liridona Ademajt e cila është vvarë në mënyrë mizore. Në emër të familjes ju falënderoj për ngushëllimet që na keni ofruar, për reagimet publike të mijëra njerëzve dhe për mbështetjen që

na keni dhënë. Liridona ka qenë grua e fortë dhe pozitive, nënë e përkushtuar dhe familjare e dashur. Atë na e morën kriminelët dhe krejt çfarë duam ne është drejtësi. Ne duam drejtësi të shpejtë dhe profesionale, pa vonesa dhe pa gabime. Kriminelët duhet të kalben në burg. Asnjë grua tjetër nuk duhet të vritet. Shpresoj që institucionet do të na lejojnë që Liridonën ta kthejmë nesër aty ku e ka vendin, në shtëpinë e saj. Me respekt, familja Ademaj", thuhet në postimin e Leonard Ademajt.

e këtij mediumi.

Autoritetet e drejtësisë ende nuk e kanë bërë me dije motivin e kësaj vrasjeje.

Policia e Kosovës ka thënë se ka kryer bastisje në Gjakovë dhe ka arritur ta sekuestrojë armën me të cilën dyshohet të jetë kryer vrasja. Vrasja është dënuar ashpër nga

zyrtarë të lartë të Kosovës dhe është bërë thirrje për zbardhjen e rastit. Me thirrjet kundër femicidit dhe dhunës me bazë gjinore, duke marrë shkas rastin e Liridonës, është protestuar të dielën në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, ndërsa të martën do të protestohet në Prishtinë.



Zgjedhjet e parakohshme në veri s'pritet të mbahen gjatë këtij viti

Prishtinë, 3 dhjetor - Zgjedhjet e parakohshme në katër komunat veriore nuk pritet të mbahen gjatë këtij viti. Nga ekzekutivi nuk konfirmojnë se ka nisur ndonjë iniciativë nga qytetarët serbë në veri që përmes peticionit të largohen kryetarët aktualë, ndërkaq opozita dhe njohësit e proceseve zgjedhore e shohin të pamundur të ndodhin zgjedhjet gjatë këtij viti. Megjithatë zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka thënë se janë pajtuar me kërkesat e BE-së që të shmangët kërkesa për numrin e telefonit në kuadër të nënshkrimit për peticion, nga zyra e tij thanë se edhe pas këtij zhvillimi gjithçka varet nga vullneti i qytetarëve atje për ta nisur peticionin.

Ndërsa deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Hajdar Beqa, thotë për "KosovaPress" se zgjedhjet në veri duhet të organizohen në bazë të ligjit dhe Kushtetutës së vendit. Duke folur për mundësinë e dorëheqjeve të kryetarëve aktualë, ai thotë se duhet të shikohet nëse ka vullnet



politik për një gjë të tillë, pasi kryetarët aktualë, pavarësisht numrit të vogël të votave, janë legjitimë. "Në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit për Zgjedhje duhet të organizohen zgjedhjet e përkohshme në veri, pasi ne nuk mund të dalim jashtë asaj kornize. Nëse ka vullnet politik mund të ndodhë një gjë e tillë por, siç po shohim ne, po humbin kohën. Kryetarët atje janë legjitimë me atë legjitimitet që e kanë, por situata si ka ardhur atje e ka një histori dhe

përgjegjës për ato veprime është kryeministri Kurti", thotë Beqa. Ndërkaq njohësi i proceseve zgjedhore, Mazllum Baraliu, thotë për "KosovaPress" se në bazë të udhëzimit administrativ dhe Ligjit për Zgjedhje Lokale, për të pasur zgjedhje të reja në komunat veriore duhet të ketë një kërkesë nga të paktën 20 për qind të trupës elektorale për shkarkimin e kryetarëve aktualë. Megjithatë, ai thekson se pas sulmit terrorist të 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit dhe

mosndëshkimit të Serbisë nuk duhet të ketë zgjedhje në veri, pasi edhe Lista Serbe është deligitimuar dhe ka humbur besimin e qytetarëve. "Çështje thelbësore dhe kërkesë ligjore e udhëzimit administrativ dhe Ligjit për Zgjedhje Lokale është që për të pasur zgjedhje duhet të bëhet një kërkesë të paktën e 20 për qind të trupës elektorale të të gjitha komuniteteve. Ky është kushti dhe nëse realizohet atëherë mund të ketë zgjedhje. Por unë mendoj se në një situatë ku as BE-ja dhe as Serbia nuk kanë reaguar në mënyrën adekuate (sulmin terrorist të 24 shtatorit) përkundër e kanë neglizhuar çështjen e agresionit ushtarak të Serbisë në veri nuk mund të ketë zgjedhje dhe përparim atje. Lista Serbe është deligitimuar dhe ka humbur besimin te qytetarët dhe institucionet tona. Duhet që edhe bashkësia ndërkombëtare të ketë një qëndrim të tillë", deklaroi Baraliu.

Edhe njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare, Dritëro Arifi, nuk

beson se do të ketë zgjedhje të reja në katër komunat veriore. "Nuk besoj se do të ketë zgjedhje në katër komunat në veri, të paktën këtë vit. Këtë vit po e shoh të humbur në shumë aspekte... (Marrëveshja politike për dorëheqjen e kryetarëve aktualë) Mund të ndodhë ajo, por zgjedhjet në veri nuk besoj se do të kenë ndonjë sukses nëse s'ka ndonjë marrëveshje politike, pasi ato do ta prodhojnë të njëjtën krizë", thotë Arifi.

Në bazë të një marrëveshjeje me Bashkimin Evropian në Bratislavë, Kosova ka treguar gatishmëri për organizimin e zgjedhjeve të reja në katër komunat me shumicë serbe në veri: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në muajin shtator ka hartuar udhëzimin administrativ që mundëson përmes peticionit largimin e kryetarëve aktualë. Kryetarët aktualë në katër komunat veriore kanë dalë nga zgjedhjet e jashtëzakonshme të prillit të cilat i ka bojkotuar komuniteti serb./kp/

Krasniqi: Qeveria Kurti i mbushi institucionet me familjarë dhe militantë partiakë

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka publikuar të dielën të gjeturat e Komisionit Evropian në raportin e fundit për Kosovën, në të cilin shënohet dështimi i qeverisë aktuale në reformën e

administratës publike. Kreu i PDK-së ka rikujtuar se qeveria Kurti, e cila kishte premtuar punësim e drejtësi, pas ardhjes në pushtet i ka mbushur institucionet e pavarura dhe bordet me familjarë dhe militantë partiakë. "Qeveria Kurti, e cila kishte premtuar

punësim e drejtësi, ka mbushur institucionet e pavarura dhe bordet me familjarë e militantë partiakë. Ndërkaq, Ligji për Paga, më shumë është padrejtësi dhe pabarazi, sesa sistem fer shpërblimi", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



Komuna e Obiliqit merr vendim për faljen e borxhit për tatimin në pronë

Obiliq, 3 dhjetor - Komuna e Obiliqit ka votuar për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej 100 eurosh për qytetarët, ndërsa është paraparë që vlera e dëmit nga ky vendim të jetë rreth 250 mijë euro. Kështu tha kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, në një intervistë për "KosovaPress", derisa flet edhe për kërkesat që ka pranuar nga qytetarët për t'u punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), bazuar në ligjin për Obiliqin. Ndërkaq për qytetarët të cilët zhvendosen nga fshatrat e Obiliqit për qëllime të KEK-ut, Gashi kërkoi t'u njihen të drejtat

ligjore për punësim në KEK, teksa shtoi se zhvendosja e banorëve në ato fshatra për interes të KEK-ut nuk është në vullnetin e qytetarëve. "Sipas të gjitha gjasave, zhvillime ka në këtë drejtim dhe ne shpresojmë që ata të bazohen edhe në Ligjin për Obiliqin, i cili e obligon KEK-un që në kushte të barabarta qytetarët të cilët janë rezidentë në komunën tonë më shumë se pesë vjet, në kushte të barabarta ta gëzojnë të drejtën e punësimit. Adresimi dhe pakënaqësitë i drejtojnë në nivel qendror. Kemi pasur takime me qytetarët e zhvendosur. Një nga kërkesat që ata e kanë

konsideroj se është shumë e drejtë dhe ajo është çështja e punësimit, pasi nuk po kërkojnë më shumë sesa një vend pune. Mendoj se ata duhet të trajtohen seriozisht, sepse janë troje shkullore dhe çdo zhvendosje që ndodh atje nuk është e vullnetshme për ata. Kjo i jep kuptim që me të vërtetë nuk është shumë nëse krijohet një mundësi punësimi për ata njerëz", tha Gashi. Sa i përket Ligjit për Obiliqin, Gashi potencoi se ka filluar të zbatohet vetëm pjesa financiare, e që shpreson të zbatohen edhe çështje të tjera të cekura në këtë ligj.



Kurti mban takim me qendrat e LV-së, kërkon zgjerimin e anëtarësisë

Prishtinë, 3 dhjetor - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryeministër i vendit, Albin Kurti, ka mbajtur takim me qendrat e kësaj partie. Sipas një njoftimi të LV-së, "në lidhje me situatën politike në vend u ritheksuan të arriturat e qeverisjes tonë dhe miratimi i buxhetit për vitin 2024 që njëherit është buxheti më i lartë i miratuar ndonjëherë në vlerë prej 3.3 miliardë euro. Pavarësisht sfidave të mëdha globale, pandemisë, luftës në Ukrainë, qeverisja jonë ka arritur të shtojë 1 miliardë euro në buxhetin e vendit për vetëm 2 vjet e gjysmë qeverisje. Krahas rritjes së të hyrave tatimore në shifra rekord, që pritet të rriten edhe më tej më 2024, edhe investimet kapitale do të ngritën në 859 milionë euro. Buxheti për 2024 do të përfshijë



investime të mëdha në ekonomi, mbështetje të bizneseve, mbështetje të punësimit,

vazhdim të mbështetjes për pjesët më të ndjeshme të shoqërisë tonë, dhe komunat

do të kenë mbështetje rekord me buxhet". Në këtë mbledhje u fol edhe për

sigurinë në vend, për ngjarjet e rënda, dhunën që po ushtrohet kohën e fundit dhe për reagimin e shpejtë, profesional dhe efikas të organeve të rendit karshi tyre duke i zënë kriminelët për t'i vënë para drejtësisë.

"Te çështjet organizative u fol për punën që po bëhet nëpër qendrat e Lëvizjes Vetëvendosje! në formimin e pikave, zgjerimin e anëtarësisë, dhe në veçanti për dy organizatat tona GVV dhe RVV të cilat kanë konsoliduar strukturat e tyre dhe tashmë po zhvillojnë aktivitete të shumta. Koncentrimi i organizatës në nivel lokal është qendror dhe duhet intensifikuar edhe më shumë prej aty ku jemi në qeverisje e deri aty ku jemi opozitë, si alternativa e vërtetë, si alternativa e duhur qeverisëse", u tha në këtë mbledhje.

Shënohet Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara, bëhet thirrje për përkrahje meritore

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara është theksuar nevoja për t'i shtuar përpjekjet për t'i hequr pengesat me të cilat përballen këta persona. Liderët e partive opozitare në vend kanë theksuar se integrimi i personave me



aftësi të kufizuar, duke u ofruar mundësi punësimi, mbështetje financiare dhe infrastrukturore, duhet të jetë objektiv shtetëror. "Ata kanë nevojë për përkrahje meritore dhe për zbatim të kornizës ligjore që garanton të drejtat e tyre", ka thënë kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi.

Ndërkaq lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se në shënimin e 3 Dhjetorit - Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara - duhet të reflektojmë si shoqëri mbi guximin dhe përpjekjet për përballjen e sfidave të paimagjinueshme çdo ditë.

Kosova, vend transit për punëtorët aziatikë



Prishtinë, 3 dhjetor - Kompania ndërtimore "Dino" nga Lipjani kishte rekrutuar njëmbëdhjetë punëtorë nga Bangladeshi për ta zëvendësuar mungesën e fuqisë punëtore, por ata qëndruan vetëm një ditë dhe "u zhdukën". Lulzim Sllamniku nga zyra ligjore e kësaj kompanie thotë se këta punëtorë parashihej të merrnin pagë deri në 500 euro në muaj, ndërsa të siguruar kishin edhe strehimin. "Nuk kemi asnjë informacion se ku kanë shkuar. Të nesërmen kur ka shkuar shoferi për t'i marrë për t'i dërguar në destinacionin e caktuar për punë, ata nuk janë paraqitur", thotë Sllamniku për "Radion Evropa e Lirë". Sllamniku shton se kohën e fundit kjo kompani, që ka 150 punëtorë, është interesuar edhe

për punëtorë të tjerë. Ai thotë se është në kërkim të rekrutimit edhe të 20 të tjerëve, por tashmë nga Turqia apo vendet e rajonit. "Sigurisht që jemi të interesuar t'i rekrutojmë punëtorët nga vendet që kanë stabilitet ekonomik", thotë ai. Muajt e fundit në Kosovë është rritur kërkesa për punëtorë të huaj. Arsytet lidhen me mungesën e punëtorëve vendas. Interesimi i tyre për të punuar, sidomos në sektorin privat, ka rënë për disa arsye, përfshirë orarin e stërzgatur të punës, pagat e ulëta, mungesën e kontratës, punën në fundjavë, mospagesën e orëve shtesë e të tjera, sipas Inspektoratit të Punës. Për rrjedhojë, kompanitë e Kosovës kërkojnë punëtorë nga jashtë, përfshirë shtetet

aziatike dhe Turqinë.

Kompania "Liri" në Prizren nga muaji gusht ka punësuar dhjetë punëtorë nga Bangladeshi dhe është në proces të rekrutimit edhe të 20 të tjerëve.

Arben Tërshnjaku, menaxher në këtë kompani, tregon se punëtorët nga Bangladeshi tashmë janë ambientuar. Sipas tij, komunikimi me ta fillimisht ka qenë i vështirë, pasi nuk e flisnin gjuhën angleze. "Shihet një mungesë e kadrove të kualifikuara dhe, normalisht, bizneset gjithmonë bëjnë zgjidhje duke kërkuar [punëtorë] edhe jashtë shtetit", thotë Tërshnjaku.

Edhe disa përfaqësues kompanish të tjera pranojnë se kanë të punësuar punëtorë nga Azia, por nuk duan të

identifikohen e të tjerë thonë se kanë pasur të punësuar punëtorë të huaj, por ata janë larguar pas disa javësh.

Gastronomia dhe ndërtimtaria janë sektorët ku ka më së shumti kërkesa për punëtorë. Kërkesat e tilla kompanitë e Kosovës i bëjnë në agjenci të ndërmjetësimit. Ramiz Ismaili, menaxher në agjencinë Elite Global Services (EGS), thotë se mundësia e largimit të të rinjve nga Kosova pas liberalizimit të vizave i ka "frikësuar" pronarët e bizneseve, të cilët kanë filluar të sigurojnë punëtorë për fillimin e vitit të ardhshëm. "Ka jashtëzakonisht shumë të interesuar. Kemi marrëveshje me dy kompani që si kërkesë fillestare e kanë rreth 150 numrin e punëtorëve që dëshirojnë t'i rekrutojnë", thotë

Ismaili për "Radion Evropa e Lirë".

Kosovarët do të mund të lëvizin pa viza në vendet evropiane nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Megjithatë, udhëtimet e tilla duhet të shërbejnë vetëm për vizita turistike apo çështje familjare, e nuk nënkuptojnë akses të lehtë pune ose përfitime të tjera. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, nga janari deri në tetor të këtij viti janë paraqitur 3 524 kërkesa për leje qëndrimi për qëllime pune në Kosovë. Prej tyre, 2 444 janë aprovuar.

Prijnë shtetasit e Turqisë, pasuar nga Serbia dhe Bangladeshi. Megjithatë, në Odën Ekonomike të Kosovës e cilësojnë si eksperiment të rrezikshëm sjelljen e punëtorëve të huaj në Kosovë.

Lulzim Rafuna, kryetar i kësaj ode, thotë se në tregun e punës ka mungesë të theksuar të fuqisë punëtore, por rekrutimi i punëtorëve aziatikë nuk është zgjidhje. Sipas tij, ata e shfrytëzojnë Kosovën si trampolinë për të arritur në ndonjërin nga vendet e Bashkimit Evropian. "Përveçse është një investim në kuptimin e shpenzimeve që kanë bizneset për t'i sjellë këta punëtorë nga jashtë në Kosovë, është edhe pasiguria se ata do të qëndrojnë në një kohë aq sa e kanë në Kosovë... Shumica prej tyre nuk vijnë me tendencën për të qëndruar dhe punuar në Kosovë", thotë Rafuna.

Në Kosovë, ku papunësia është rreth 12 për qind, sektori privat llogaritet punëdhënësi më i madh, me më shumë se 300 mijë punëtorë.

Paga mesatare bruto në këtë sektor është rreth 470 euro.

Dogana kalon 1.5 miliard euro të hyra

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Dogana e Kosovës ka përmbyllur raportin e të hyrave me 1.5 miliard euro. Siç thotë Dogana, ky rezultat është edhe një rekord tjetër i shënuar. "Të hyrat sivjet tejkalojnë të hyrat për të njëjtën periudhë për 124 milionë apo 9 % më shumë të hyra. Dogana e Kosovës, gjithashtu, është duke shënuar rezultate shumë pozitive edhe në luftimin e ekonomisë joformale dhe mbrojtjen e shoqërisë nga mallrat e ndaluara. Edhe raporti i fundit për vendin nga Komisioni Evropian ka theksuar performancën e mirë të Doganës së Kosovës në disa fusha të rëndësishme, ndërsa që kryesore është theksi për performancën e mirë në luftimin e krimit të organizuar dhe kontributi në kuadër të reformave të qeverisë në



luftimin e ekonomisë joformale", thuhet në njoftim. Po në njoftim thuhet se kanë

trajtuar me efikasitet çështjet e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsionit, duke

synuar ta avancojmë integritetin e organizatës si dhe orientimin në shërbim.

"Dogana e Kosovës është mirënjohëse për përkrahjen e përzervë nga qeveria në efikasitetin e deritanishëm dhe çmojmë përkrahjen e partnerëve, Ambasadës së ShBA-së, Britanisë së Madhe, Zyrës së BE-së në Prishtinë, projektet e GIZ-it gjerman dhe organizatat ndërkombëtare të cilët janë duke na ndihmuar për avancimin e kapaciteteve. Kontributi dhe bashkëpunimi me komunitetin e bizneseve si dhe me publikun ka qenë i rëndësishëm kritike për rezultatet tona të deritanishme, andaj ky bashkëpunim mbetet në qendër të vëmendjes sonë, me qëllim që t'i promovojmë vlerat e mirëbesimit dhe të avancojmë shërbimet. Kryesor mbetet transformimi digjital dhe në përgjithësi lehtësirat tregtare".

9 korrik 1971: Amerika zbulon Kinën



Udhëtimi që tepër sekret. Henry Kissinger e arriti nga Pakistani kryeqytetin e vendit komunist që me Shtetet e Bashkuara ndante armikun: Bashkimin Sovjetik. Sekretari i Shtetit u prit nga kryeministri Çu En Lai, udhëtimi përgatiti udhëtimin e presidentit Richard Nixon tek Mao Ce Duni. Dhe historia ndryshoi

«Doktor Kissinger, ka një lajm special që ju përket: ju jeni i humbur». Qe kështu që Çu En Lai priti Këshilltarin e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara 50 vite më parë, më 9 korrik 1971 në Pekin. Nj shprehje prej spy story, e përshtatur me rrethanat e këtij takimi të parë sekret. Batuta e kryeministrit komunist u vërejt nga Winston Lord, i riu asistent i Kissinger, që e transkriptoi në një memo prej 110 faqesh e përcaktuar si «Top secret/ sensitive/ exclusively eyes only». Do të qëndronte e mbyllur për 30 vjet në arkivat e Shtëpisë së Bardhë. «La Lettura» e rihap sot, ndërsa politologë nga njëra anë dhe tjetra e Paqësorit studiojnë këtë operacion diplomatik që ka

ndryshuar raportet dhe ekuilibrat e forcës midis Perëndimit e Lindjes dhe pyesin nëse çtensionimi midis dy superfuqive mund të ringjallet me goditje të reja prapaskene. Në Pekin, që ka kultin e historisë, nostalgjia është e fortë, nderon Kissinger me titullin zhongguo renmin de lao pengyou, «mik i vjetër i popullit kinez», dhe e ka pritur e dëgjuar në më shumë se 80 raste pas atij zbarkimi të mbështjellë me mister. Përqafimi spektakolar i 1971 midis Shteteve të Bashkuara dhe Republikës Popullore të Kinës është përkufizuar në mënyra të ndryshme. «Diplomaci trekëndore», «minuet», «taktika e dhelprës përballë asaj të iriqit»,

edhe «ndërtimi i Frankenstein». Çdo përkufizim pasqyron një pjesë të realitetit, me emrin e koduar të dhënë operacionit: «Marco Polo». Presidenti Richard Nixon kishte vendosur të futej në të çarën e rivalitetit të egër midis Moskës dhe Pekinit duke luajtur me dy porta, duke krijuar marrëdhënie më të ngushta si me Kinën, ashtu edhe me Bashkimin Sovjetik se ato që të dy vendet komuniste kishin midis tyre. Tani është e ligjshme të mendohet edhe se solidariteti i madh edhe personal i lëvduar nga Xi Jinping dhe Vladimir Putin është një replikë teatrale e lojës së vjetër trekëndore dhe se takimi i qershorit në Gjenevë midis Joe Biden dhe carit rus është tentativa e një kundërlëvizjeje amerikane. Le të kthehemi tek historia. Prej muajsh, nëpërmjet ndërmjetësish të huaj, amerikanë dhe kinezë kishin shkëmbyer sinjale në distancë nëpërmjet kanaleve të gjata të lodhshme: u regjistruan 136 kontakte, nga Parisi në Varshavë, pa asnjë rezultat. «Këtyre

tentativave ne u kishim vënë emrin e koduar «Minuet», pasi njëlloj si një vallëzim në çift, po ecnim me hapa të vegjël, duke kërkuar që të përshtasnim hapa, por ishte e vështirë», kujton profesor Tao Ven Zhao i Akademisë së Shkencave Sociale të Pekinit. Bisedimet eksploruese përplaseshin me njëherë me shkëmbinjtë e deklaratave të ngarkuara me ideologji. Mosbesimi ishte kultivuar prej 20 vjetësh, qysh kur Mao Ce Duni i tetorin e 1949 kishte shpallur lindjen e Republikës Popullore dhe Uashingtoni ishte rreshtuar nga ana e Çian Kai Shisë, i fortifikuar në Tajvan. Pastaj 3 vitet e luftës në Kore, kur një armatë me «vullnetarë kinezë» ishte përplasur kundër forcave të Kombeve të Bashkuara të udhëhequra nga amerikanët. Imazhi simbol mbetej ai i Sekretarit të Shtetit amerikan John Foster Dulles, i cili gjatë konferencës së paqes për Korenë më 1954 në Gjenevë, kishte refuzuar t'i jepte dorën Çu En Lait. Në janarin e 1969, i

sapozgjedhur president, Richard Nixon kishte kërkuar ta prishte «izolimën e zemëruar» (siç e quajti). Alexander Haig, që në atë kohë ishte numri dy i National Security Council, e kujton kështu: «Duke dalë nga Salla Ovale, Henry Kissinger më tha: «Al, shefi do të krijojë marrëdhënie me Kinën». Unë ju përgjigja: «Duhet ta kesh kuptuar keq, ai është luftëtar i Luftës së Ftohtë». Kissinger ma ktheu: «Mendoj se nuk është në vete». Nixon ishte i kthjellët. Donte t'i kapte kinezët për të hapur një front tjetër dhe të rrethonte Bashkimin Sovjetik. Por tentativat e para nuk çuan në asgjë. Për komedi episodi i ndodhur në Varshavë më 1970. Ambasadori amerikan në Poloni ishte ngarkuar t'i dorëzonte një mesazh kinezëve, por asnjë diplomat komunist nuk donte të rrezikonte që të shihej afër me një «armik imperialist». Rasti edhe në një vend të pamundur: një sfilatë mode jugosllave në kryeqytetin polak. Kur amerikanët panë në sallë disa funksionarë kinezë, nisën t'u

“E ndërkohë plakesh, i bindur se vite më të mira do të vijnë”. Thënie të veçanta nga Vasco Rossi

“Të ndalesh, në thelb, është si të vdesësh”.

“E ndërkohë plakesh, i bindur se vite më të mira do të vijnë”.

“Sepse me kohën ndryshon gjithçka, ndryshojmë edhe ne”.

“Ndjesitë, nuk janë asnjëherë tepër. Shumë shpejt mësohesh, lodhesh, por është e pamundur të jetosh pa to”.

“Nuk ka rëndësi që jeta është e

shkurtër, duhet ta jetosh thellësisht”.

“Të harrosh është e thjeshtë, mjafton të mos e kujtosh çfarë të ka ndodhur”.

“Më kap dorën dhe më trego se nuk ka gjëra të pamundura”.

“Nëse diçka nuk e beson vetë ti, nuk ka se si ta besojë askush”.

“Jeta nuk është si një komedi që mund ta provosh paraprakisht.

Duhet ta jetosh spontanisht”.

“Këngët janë si lulet që lindin nga dielli, janë si ëndrrat që nuk na mbetet gjë tjetër, veçse t'i shkruajmë me nxitim, sepse më vonë fshihen dhe nuk i mban dot mend”.

“Dënimi i parë: Duhet të kesh respekt për veten tënde. Kur e respekton veten dhe nuk e demoralizon atë, ke hedhur një hap të rëndësishëm për të jetuar”.



bëjnë shenja, duke kërkuar t'ju afroheshin. Këta të fundit, që nuk kishin marrë udhëzime nga Pekini, u ngritën dhe ju drejtuan me shpejtësi daljes për të shpëtuar nga sikleti; filloi një ndjekje; në fund një amerikan ju ulëriu në polonisht, gjuha e vetme që kishin të përbashkët: «Jemi nga ambasada e Shteteve të Bashkuara, duam të takojmë ambasadorin tuaj... Presidenti Nixon dëshiron të rifillojë bisedimet».

Edhe Mao kishte kanalet e tij të brishta të komunikimit. Një prej të preferuarve ishte Edgar Snow, gazetari amerikan që në vitin 1936 e kishte intervistuar në Jenan, pika kryesore e Marshimit të Madh midis maleve të Shaanxisë. Ka qenë Snow ai që ka bërë fotografinë e famshme ku udhëheqësi komunist mban veshur një berretë me yllin e kuq. Në vjeshtën e 1970 Snow u ftua në Pekin për ta dëgjuar sërish Timonierin e Madh, por diplomacia kineze e trajtoi atë intervistë ku Mao fliste për dialogun e mundshëm me Nixon si një mesazh të futur në një shishe dhe të hedhur në oqean. Snow ju tha që të mos i fuste në thonjëza fjalët e Kryetarit dhe të mos e botonte artkullin përpara 3 muajve. Mao ishte treguar shumë dinak, duke e imagjinuar se gazetari gjithësesi do të pyetej menjëherë në Uashington dhe do të tregonte propozimin për ta pritur Nixon në Qytetin e Ndaluar «si kryetar shteti apo si turist». Nuk ndodhi kështu, pasi Shtëpia e Bardhë e konsideronte si gjysmë komunist. Kur intervista u botua më 30 prill 1971 në revistën «Life», ajo ishte tejkaluar tashmë nga ngjarjet dhe (ndoshta) nga rastësia.

Ishte 4 prilli i 1971 në Nagoya të Japonisë. Kampionati botëror i pingpongut. Pingpongisti amerikan Glenn Cowan, një djalosh hippi i padisiplinuar, kishte humbur autobuzin e ekipit të tij. Po nisej ai kinez dhe ai hipi në të: nuk është sqaruar kurrë nëse gabimisht, për provokim apo sepse ju ofrua një udhëtim. Gjithësesi një gjest kundër protokollit, pasi në ato kohë atletëve të Pekinit ju ndalohej edhe vetëm t'i thonin një fjalë kapitalistëve jenki. Por në autobuz ishte një pingpongist kinez aq shumë i dashur në vendin e tij sa të mundësonte një shkleje të guximshme: Zhuan Ce Dun, tri

herë kampion bote, që kishte shpikur një mënyrë revolucionare të mbajtjes së raketës të pingpongut dhe atë ditë shpiku edhe «diplomacinë e pingpongut». Në atë autobuz kishte hipur historia, por në fillim pati ngricë.

«Patën kaluar 10 minuta dhe askush nga ekipi yno nuk kishte guxuar ta shikonte të huajin në fytyrë. Por unë mendova se ishte vetëm një sportist, jo politikan. U ngrita, i fola përkthyesit dhe shkova ta përshëndesja», ka treguar më pas në shumë raste Zhuan. Ajo që kampioni kinez i tha kundërshtarit amerikan Cowan ka hyrë në legjendë: «Edhe pse qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk është miqësore ndaj Kinës, amerikanët janë miq të kinezëve. Po të bëj një dhuratë për ta provuar». Kinezi nxorri nga çanta një shall mëndafshi me të stampuar në të një pamje të maleve Huangshan, aty ndodheshin fotoreporterë dhe fotografia e çastit përfundoi nëpër gazeta.

Tregohet se pasi pa këtë fotografi Mao urdhëroi menjëherë të ftohej ekipi amerikan në Kinë. Por gjërat nuk shkuan saktësisht kështu, pasi edhe revolucionari i moshuar ishte i paqartë lidhur me reagimin e masaës kineze. Orët që çuan tek vendimi u treguan vite më vonë nga Vu Xu Jun, infermiera – asistente e Kryetarit. Mao, që tashmë ishte i sëmurë, merrte ilaçe gjumi përpara se të hante. Ato qenë aq të forta sa që ja hiqnin

menjëherë kthjelltësinë, prandaj Timonieri kishte vendosur që «pas marrjes së ilaçeve të gjumit, fjalët e tij duhej të injoroheshin dhe të harroheshin».

Në orën 23 të asaj nate të 4 prillit «u shtriu dhe foli, pëshpëriste fjalët dhe mu desh kohë për t'ia kuptuar, donte që t'i telefonoja Çu En Lait që të fronte lojtarët amerikanë. Isha e shqetësuar dhe e frikësuar, e pyesja nëse fjalët e tij në atë moment vlenin apo jo, pavarësisht urdhërave të tij lidhur me qetësimin. Ai u duk sikur u përgjum sërish, por pak kohë më pas hapi sytë dhe më tha: «Vogëlushja Vu, pse nuk e bën atë që të kam kërkuar? Bëje shpejt, ndryshe do ta humbasim këtë rast». Topi ishte në fushën amerikane. Pas atij për sportistët, në Uashington mbrriti një mesazh i Çu En Lait që ofrohej për një takim me një funksionar të Shtëpisë së Bardhë. Zgjedhja e negociatorit nuk qe e lehtë. Nixon kishte frikë se mos këshilltari i vidhte skenën.

Skartoi zëvendës-presidentin Nelson Rockefeller pasi ishte «amator»; George Bush Sr., atëbotë ambasador në Kombet e Bashkuara, sepse «shumë i dobët dhe pak i sofistikuar». Në fund, duke ngarkuar Kissinger, për të shmangur konflikte të brendshme në administratë dhe pyetje për konsultime të aleatëve, i urdhëroi fshehtësi maksimale.

Më 1 korrik 1971 delegacioni amerikan u nis për një udhëtim

të gjatë: «Zgjedhëm të bënim etapa cilitëse dhe të mërzhitshme në kryeqytete të ndryshme, nga Sajgoni në Bangkok, New Delhi dhe në fund Rawalpindi, për të shkurajuar gazetarët», shkruan në kujtimet e tij Kissinger. Vetëm dikatori gjeneral i Pakistanit, Yahya Khan, ishte në dijeni të planit, pasi gëzonte besimin e të dyja palëve dhe bashkëpunimi logjistik i tij ishte vendimtar. Mbrëmjen e 8 korrikut, gjatë një banketi në Pakistan, Kissinger u shtir si i sëmurë, la sallën, hipi në një makinë dhe drejt për në aeroport. Avioni pakistanez e priste në pistë. Në bordin e tij ndodheshin 4 të dërguar kinezë. Kissinger kishte me vete 3 asistentë të rinj. 2 agjentët e Secret Service nuk dinin gjë për destinacionin: «Kur panë kinezët në avion, menduan se po bëhej një tentativë kidnapimi, thuajse u ra infarkt».

Në ngut e sipër u bë një gabim i vetëm: çanta 24 orëshe me ndërresat e Kissinger mbeti në bagazhin e makinës. Për të çtensionuar tensionin e futurimit, një bashkëpunëtor i tha: «Henry, akoma nuk je ulur ende në tryezë me kinezët dhe je pa këmishë». Tregojnë se asistenti John Holdridge i dha një prej të tijave, që i rrinte e madhe sepse ishte një pëllëmbë më i gjatë, aq sa ta «bënte të dukej si pinguin». Dhe në qafën e saj lexohej etiketa Made in Taiwan. Një shenjë e fatit.

Ja përballë me Çu En Lait. Shënimi i dytë i takimit: «Kryeministri Çu i ofroi cigare mysafirëve. «Askush nuk do? Paskam gjetur një grup joduanpirësish». Në dukje, i plotfuqishmi kinez dukej i relaksuar; Kissinger ngutej, pasi mbështetej vetëm mbi një hapësirë 48 orëshe përpara se t'i duhej të rishfaqej në Pakistan pa krijuar dyshime.

Kishte shumë çështje për të diskutuar dhe këtu hyn në lojë «teoria e dhelprës dhe e iriqit», e evokuar nga historiani Niall Ferguson. Dhelpra amerikane kishte shumë objektiva: i pari ishte të organizohej vizita shtetërore e Nixon në Pekin; pastaj duhej të merreshin garancitë kineze për çimpenjimin ushtarak nga Vietnam; të stabilizohej Koreja; të ushtrohej presion ndaj sovjetikëve; të ngadalësohej gara e armatimeve; të mbyllej lufta e pavarësisë së Bangladeshit nga Pakistani. Çu En Lait ishte iriq,

donte të fliste për Tajvanin: «Për ju ka një vlerë të paktë strategjike, kurse për Kinën është një plagë e hapur. Po nuk e zgjidhëm shpejt çështjen, do të jetë e kotë të shkohet më tej». Kissinger kërkonte të ruhej ambiguiteti: «Si studiues i historisë mund të parashikoj se evolucionin politik do të ecë paqësisht në drejtimin që kërkon...». Çuja donte përgjigje më të prera. Në fund amerikan pranoi ta njohë Republikën Popullore të Kinës si qeverinë e vetme legjitime të Kinës, duke e braktisur Tajvanin në fatin e tij «në një horizont kohor të pajtueshëm me nevojat e brendshme e Shteteve të Bashkuara».

Në vijim, Kissinger ka bërë dy vlerësime: «Diplomacia nuk duhet të jetë sentimentale, por e parashikueshme» dhe «Pekini është demonstruar jashtëzakonisht fleksibël lidhur me afatet e zbatimit të parimit e ekzistencës së një Kine të vetme, presidentët amerikanë kanë ndjekur me aftësi një pozicion ekuilibri, duke u afruar me Republikën Popullore të Kinës dhe duke ruajtur kushtet për zhvillimin e demokracisë në Taipei».

Tani Xi Jinping thotë se çështja e ribashkimit nuk mund t'u lihet më gjeneratave të ardhshme dhe prej muajsh avionë kinezë kryejnë fluturime të përditshme rreth ishullit, në aksione që duken si prova gjenerale. Më 11 korrik të 1971 Henry Kissinger u kthye fshehurazi në Rawalpindi dhe, duke folur me shokët e tij të udhëtimit, dha provë të asaj mungese sentimentalizmi që predikonte: «Yahya Khan nuk është argëtuar shumë nga masakra e fundit», tha duke ju referuar masakrave bengaleze të kryera nga diktatori pakistanez. Më 15 korrik u njoftua marrëveshja për vizitën e Nixon në Pekino. Më 21 shkurt të 1972 presidenti i Shteteve të Bashkuara takoi Kryetarin Mao dhe më 28 shkurt u deklarua se ka vetëm një Kinë, duke tokur gotat për «javën që ka ndryshuar botën». Dhelpra e mendonte veten fituese. 50 vite më vonë, Xi Jinping shpall se «Lindja është në ngjitje dhe Perëndimi në rënie». Të vjen në mendje një pranim i fundit i Nixon në një intervistë të vitit 1994: «Doniam t'ia hapnim Kinën botës, por pyes veten mos vallë kemi krijuar ndonjë Frankenstein».

Përgatiti: ARMIN TIRANA /
bota.al



“Do të bësh, do të jesh, do të bëhesh”. Fjalimi më i bukur motivues nga Alessia Esposito

“Ndoshta një ditë do të bësh një tatuazh, do të gabosh në zgjedhjen e fakultetit, do të bësh një udhëtim pa lekë në xhep, do të kesh një lokal të preferuar, do t'i bësh flokët blu, do t'i besosh dikujt që do të bëjë keq (sepse ti mendon se të besosh është diçka e mirë), do të dashurohesh e do të presësh, do të bësh zjarrfikësin ose arkitektin, ose avokatit, ose do të jesh parukieri më i mirë i lagjes. Do të udhëtosh ose jo, do të shkruash një libër, do t'i biesh violinës, baterisë ose pianos.

Mund ta urresh matematikën dhe tëduash filozofinë. Ose mund të doktorohesh në statistikë.

DO TË BËSH, DO TË JESH, DO TË BËHESH.

E tashmja, njësoj sikurse e ardhmja, do të jenë të tuat. Do të jenë për ty. Por kjo gjë nuk shkruhet në dëftesën e shkollës. Të lutem ta mbash mend këtë gjë. Ti nuk je as një 10, një 7, një 8 apo një 5 që mund të kesh marrë. Nuk do të jesh as 18

pikëshi minimal, apo 30 pikëshi maksimal në provimet e universitetit. Jeta sigurisht mund të rrotullohet rreth numrave, por ti nuk je, nuk do të jesh dhe nuk vlen sa një numër. Vlen shumë më tepër. Beso tek vetja dhe pikë. Beso tek instrumentat që të janë dhënë dhuratë për të përballuar botën dhe shkunde zemrën e njerëzve. Pranoje rënien dhe më pas, nis fluturimin. TI KE LINDUR PËR TË QENËI LUMTUR”. – Alessia Esposito



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Invert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Fitojnë Ballkani dhe Drita, Dukagjini ndahet baras me Prishtinën

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kampionia në fuqi e Superligës, Ballkani ka vazhduar me fitore pasi në kuadër të javës së 16-të e mposhti Fushë Kosovën me rezultat 2-1. Pas minutave lojë, Osman Mëziut realizoi një supergol për rezultatin 0-1, por suharekasit e barazuan rezultatin në fund të pjesës së parë me anë të Walid Hamidit. Ballkani e dominoi pjesën e dytë, por golin e fitores e shënoi vetëm tre minuta para fundit të ndeshjes me anë të mesfushorit Qëndrim Zyba. Pas kësaj ndeshje, skuadra e Ilir Dajës është në vend të parë me 38 pikë, derisa Fushë Kosova renditet në vendin e parafundit me vetëm 10

pikë. Në ndeshjen tjetër, trajneri Zekirija Ramadani ka debutuar me fitore në krye të skuadrës së Dritës, derisa kjo e fundit e mposhti Feronikelit 74 me rezultat 3-1. Në pjesën e parë dy gola për gjilanasit i shënuan Blerim Krasniqi (32), Blend Baftiu (34), derisa në pjesën e dytë përkatësisht në fund të ndeshjes shënoi edhe Albin Prapashtica për Dritën, derisa për "Niklin" golin e vetëm e shënoi Bachare Razack. Drita është e dyta në tabelë me 28 pikë, kurse "Nikli" në vendin e tetë me 15 pikë. Në ndeshjen e tretë të zhvilluar të dielën, Dukagjini dhe Prishtina i ndan pikët duke luajtur baras me rezultat 0-0. Prishtina zë vendin e pestë në tabelë me 22 pikë, një pozitë më poshtë dhe me një pikë me pak është Dukagjini.



Të shtunën Malisheva ka shënuar fitore si mysafire në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, duke e mposhtur Llapin (0-1). Fituesin e kësaj ndeshje e vendosi goli i

hershëm i Agon Xhakës, me kokë nga afërsia, në minutën e 6-të. Ndërkaq, në ndeshjen tjetër të zhvilluar në "Përparim Thaçi" në Prizren, Gjilani e ka mundur

Lirinë, me rezultat bindës 4-0, me golat e shënuar nga Edi Basha (23), Elvedin Heriq (26, 30) dhe Elton Cale (85).

SUPERLIGA		
Drita - Feronikeli		3-1
Ballkani - Fushë Kosova		2-1
Dukagjini - Prishtina		0-0
Llapi - Malisheva		0-1
Liria - Gjilani		0-4
Tabela		
	Pikë	
1. Ballkani	14	38
2. Drita	15	28
3. Llapi	16	28
4. Malisheva	16	23
5. Prishtina	16	22
6. Dukagjini	16	21
7. Gjilani	15	17
8. Feronikeli 74	16	15
9. Fushë Kosova	16	10
10. Liria	16	9

Prizreni fiton derbin e qytetit, Prishtina shkatërroi Istogun

Prizren, 3 dhjetor - Derbi i qytetit i ka takuar Proton Cable Prizrenit, që shënoi fitore ndaj Bashkimit me shifrat 90:82 (18:26, 24:20, 25:23, 23:13), në xhiron e 11-të të Prince Caffë Superligës. Basketbollistët e Bashkimit e nisën ndeshjen më mirë dhe që në çerekun e parë krijuan epërsi prej dhjetë pikësh, 11:21, derisa këtë pjesë e fituan 18:26. Por, Proton Cable Prizreni nuk u dorëzua dhe ngushtoi shifrat minimalisht në 38:39, derisa pjesa e parë përfundoi 42:46. Lojë më e barabartë u zhvillua në periudhën e tretë, ku Prizreni arrin të kalojë në epërsi në

65:64, ndërsa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 67:69. Proton Cable kishte epërsi në dhjetë minutat e fundit në 83:73, por nga ky moment Portokallezjinjtë filluan një seri të suksesshme, për të afruar rezultatin në 83:82, megjithatë, në fund më të përqendruar ishin basketbollistët e Proton Cable Prizrenit që triumfuan 90:82. Desi Sills ishte më i miri te Proton Cable Prizreni me 28 pikë, pesë kërcime e pesë asistime, derisa Altin Morina ishte më i dalluari te Bashkimi me 13 pikë, gjashtë kërcime e 12 asistime. Tani të dy



skuadrat kanë nga katër fitore e shtatë humbje. Sigal Prishtina u është rikthyer fitoreve, duke mundur pa shumë

probleme Istogun me rezultat 117:63 (27:17, 28:13, 30:19, 32:14), në javën e 11-të të Prince Caffë Superligës. Ndeshja në fakt nuk

kishte shumë histori, me vendasit që dominuan nga fillimi deri në fund, për të shënuar fitore të sigurt, duke mos e rrezikuar asnjëherë dhe triumfuan në fund 117:63, që ishte më e larta për kryeqytetasit në këtë edicion. Te Prishtina të gjithë basketbollistët që luajtën shënuan, ndërsa më të dalluarit ishin Fisnik Rugova me 21 pikë e 13 kërcime dhe Dardan Berisha me 21 pikë e 11 asistime, kurse te Istogu, 12 pikë shënoi Tyres Prince, kurse nga 11 shtuan Kahlon Witeley dhe Arian Azemi. Prishtinasit kanë gjashtë fitore e pesë humbje, kurse istogasit një fitore e dhjetë humbje.

Fitorja e dymbëdhjetë për Rahovecin, e shtata për Prishtinën



RAHOVEC, 3 DHJETOR - Rahoveci nuk ka të ndalur në Superligën e Kosovës në hendboll. "Vreshtarët" e kanë shënuar edhe fitoren e 12-të rresht dhe udhëheqin në tabelë me 24 pikë. Të dielën në palestrën "Mizahir Isma", Rahoveci fitoi ndaj Vushtrrisë me rezultat 47:27. Dallimi në cilësi ishte i madh dhe kjo u bë e qartë në minutat e parë të takimit. Adonit Isufi ishte më

efikasi te Rahoveci me dhjetë gola. Gjashtë i kishte Mali Luzha, ndërsa nga pesë i shënuan Jeton Bislimi e Alban Haziri. Te Vushtrria tetë gola i kishte Muhamet Hyseni, ndërsa shtatë i shënoi Amir Fazliu. Vushtrria është e parafundit me dy pikë, sa i ka edhe Vëllaznimi në vendin e fundit. Po të dielën, Vëllaznimi humbi 36:25 nga Prishtina, në ndeshjen tjetër

të xhiros së 12-të. Pas pjesës së parë dallimi ishte dhjetë gola në të mirë të Prishtinës. 20:10. Albi Gjuka i kishte nëntë gola për Prishtinën, ndërsa shtatë i shënoi Agon Bajqinovci. Te Vëllaznimi nga pesë gola i realizuan Luigj Kolaj dhe Ardi Halili. Prishtina shënoi fitoren e shtatë të edicionit. Renditet e pesta me 14 pikë, sa i ka edhe Kastrioti në vendin e katërt.

Përrurohet shtatorja e Erion Kajtazit në Mitrovicë

MITROVICË, 3 DHJETOR - Në një ceremoni të dielën në Mitrovicë u përurua shtatorja e futbollistit të ri të këtij qyteti Erion Kajtazi, një vit pas ndarjes nga jeta. Kajtazi pësoi sulm në zemër gjatë ndeshjes së Superligës së juniorëve, A&N-Trepça'89. Ai ishte një talent i jashtëzakonshëm, i cili la pas një trashëgimi të pashlyeshme në zemrat e

familjarëve, bashkëlojtarëve, miqve dhe tifozëve të futbollit. Shtatorja e Erionit do të jetë një simbol ku brezat e rinj do të frymëzohen për lojën e futbollit, ndërsa stadiumi, që tani mban emrin e tij me krenari, do të bëhet një shenjë e pavdekshme e talentit dhe dedikimit të një futbollisti që u nda shumë herët nga jeta. Në pamundësi për të qenë i pranishëm në

këtë ceremoni për shkak të vizitës në UEFA, presidenti Agim Ademi vlerëson lart të gjithë ata që kontribuan në realizimin e kësaj shtatoreje, në veçanti klubin Trepça '89 dhe Komunën e Mitrovicës. Erion Kajtazi do të mbetet gjithmonë në kujtesën tonë dhe shtatorja e tij prej bronzi do të jetë një ndriçim i përjetshëm i futbollit kosovar.



